



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 146, datë 27.10.2011

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “MBI BAZAT, METODAT E LLOGARITJES SI DHE MËNYRAT E MBAJTJES SË PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SIGURIMEVE TË JO-JETËS.”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, nenit 128 të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes Drejtoria e Administrimit të Riskut, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në rregulloren “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës”, të miratuar me vendimin nr. 9, datë 08.02.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Elisabeta GJONI**

Në rregulloren “Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës” të miratuar me Vendimin nr. 9, datë 08.02.2007, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, bëhen këto ndryshime:

- a. Neni 2 germa (i), në Paragrafin e parë fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë vijon:
“Për llogaritjen e tij mund të përdoren një nga tre mënyrat e mëposhtme.”
- b. Neni 2 germa (i), në Paragrafin e parë në fund shtohet fjalia, si më poshtë vijon:
“Kalkulimi i provigjonit teknik i primit të pafituar do të behet mbi primin bruto të shkruar, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar.”
- c. Neni 2 germa (i), pika 2.1 shfuqizohet.
- ç. Neni 2 germa (i), pika 2.2 bëhet pika 2.1 si dhe ndryshohet si më poshtë vijon:
“2.1 Konsiderojmë një policë të vetme për sigurimin e dëmeve. Duke supozuar që shpërndarja e rrezikut gjatë kohëzgjatjes së policës është uniforme dhe së ekspozimi ndaj rrezikut nën një policë vjetore të shkruar në muajin m, fillon në mesin e muajit, atëherë UPR për policën në konsideratë do të jetë: $(2m-1)/24 \cdot P$, ku P është primi bruto i shkruar.”
- d. Neni 2 germa (i), pika 2.3 bëhet pika 2.2 si dhe ndryshohet si më poshtë vijon:
“2.2 Konsiderojmë një policë të vetme për sigurimin e dëmeve. Duke supozuar që shpërndarja e rrezikut gjatë kohëzgjatjes së policës është uniforme gjatë ditëve të policës, atëherë UPR do të jetë: $(\text{ditë të mbetura nga dita e fundit të muajit të polices} - \text{ditë gjithsej të policës}) / (\text{ditë gjithsej të policës}) \cdot P$, ku P është primi bruto i shkruar.”
- dh. Neni 2 germa (i), pika 2.4 bëhet pika 2.3 si dhe ndryshohet si më poshtë vijon:
“2.3 Me metodën e mëposhtme, bëhet edhe rregullimi përkatës për inflacionin në llogaritjen për UPR. Një policë e sigurimit të dëmeve, e lëshuar në kohën $t=(0 < T < 1)$ në fund të vitit financiar kërkon një UPR të barabartë me $t^{-1} (1 + i)^{0.5} [(1 + i)^T - 1] \cdot P$, ku i është shkalla e inflacionit në koston e dëmeve dhe P është primi bruto i shkruar.”
- e. Aneks 2, tabela 2, rreshti i tretë, pas fjalisë “Të dhëna lidhur me dëmin:” shtohet fjalia si më poshtë vijon:
“emri i shkaktarit të demit (për sigurimet motorike), emri i përfituesit të dëmshpërblimit, targat (për sigurimet motorike), objekti i dëmtuar (për sigurimet pasurore).”
- ë. Aneks 2, tabela 2, rreshti i tetë, pas fjalisë “Lloji i dëmit (ne mënyrë të veçuar nëse është pasuror, dëmtim trupor)” shtohet fjalia si më poshtë vijon:
“(të specifikohet nëse është dëm me pasojë vdekjen apo paaftësi e përkohshme/përhershme)”
- f. Aneks 2, tabela 2, rreshti i katërmëdhjetë, pas fjalëve “praktikë e mbyllur,” shtohen fjalët si më poshtë vijon:

“ proces gjyqësor, refuzuar etj.)”

- g. Termi “prim i sigurimit” në rregullore zëvendësohet me termin “prim bruto i shkruar”.